

**L I G J**  
**Nr.8446, datë 25.1.1999**

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR ELIMINIMIN E TATIMEVE TË DYFISHTA  
LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PËR  
PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë për eliminimin e tatimeve të dyfishta, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.2306, datë 3.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**K O N V E N T Ë**  
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË NORVEGJISË PËR  
ELIMINIMIN E TATIMEVE TË DYFISHTA LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT  
DHE MBI KAPITALIN DHE PËR SHMANGIEN E EVAZIONIT FISKAL QEVERIA E  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERIA E MBRETËRISË SË NORVEGJISË**

Duke dëshiruar, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe lehtësimin e marrëdhënieve ekonomike, të përfundojnë një Konventë për eliminimin e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për shmangien e evazionit fiskal,  
kanë rënë dakord për sa vijon:

**Neni 1**

**Fushëveprimi i Konventës**

Kjo Konventë do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose e të dy Shteteve Kontraktuese.

## Neni 2

### Tatimet që mbulon konventa

1. Kjo Konventë do të zbatohet ndaj tatimeve mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të vendosura në emër të një Shteti Kontraktues ose nëndarje të tij politike apo autoritete lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e aplikuara mbi të ardhurat në total, mbi kapitalin në total, ose mbi elemente të të ardhurave apo të kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Konventa janë në veçanti:

a) Në Shqipëri:

(i) tatimi mbi fitimet e personave juridikë;

(ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

(iii) tatimi mbi të ardhurat personale;

(iv) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t'i referohemi si "tatimet Shqiptare").

b) Në Norvegji:

(i) tatimi kombëtar mbi të ardhurat;

(ii) tatimi rajonal bashkiak mbi të ardhurat;

(iii) tatimi bashkiak mbi të ardhurat;

(iv) kontributet nacionale për Fondin e Barazimit të Tatimit;

(v) tatimi nacional mbi kapitalin;

(vi) tatimi bashkiak mbi kapitalin;

(vii) tatimi nacional lidhur me të ardhurat dhe kapitalin nga zbulimi dhe shfrytëzimi i burimeve të naftës në det dhe aktivitetet dhe puna e lidhur me to, përfshirë transportin me tubacione të naftës së prodhuar; dhe

(viii) tatimet nacionale mbi shpërblimin e artistëve jorezidentë;

(hereinafter referred to as "Norwegian tax").

4. Konventa do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllajta ose tepër të ngjashme të cilat do të vendosen nga secili Shtet Kontraktues pas datës së nënshkrimit të Konventës si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese.

## Neni 3

### Përcaktime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë, dhe kur përdoret në sensin gjeografik nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë përfshirë zonën tej ujrave territoriale të Republikës së Shqipërisë e cila, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi "Norvegjia" nënkupton Mbretërinë e Norvegjisë, përfshirë çdo zonë jashtë ujrave territoriale të Mbretërisë së Norvegjisë, ku Mbretëria e Norvegjisë, në bazë të legjislacionit Norvegjez dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, mund të ushtrojë të drejtat e saj lidhur me tabanin detar nëntokën dhe burimet e tyre natyrore; Termi nuk përfshin Svalbard, Jan Mayen dhe varësitë "biland" Norvegjeze;

c) termi "person" përfshin një individ, një shoqëri (kompani) dhe çdo grup tjetër personash;

d) termi "shoqëri (kompani)" nënkupton çdo organ korporativ ose çdo ent që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

e) termat "sipërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "sipërmarrje e Shtetit tjetër

Kontraktues” nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

f) termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije ose avjon që operohet nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues, përveç kur anija ose avjoni vepron vetëm midis vendeve të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues;

g) termi “autoritet kompetent” nënkupton:

(i) në Shqipëri, Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij;

(ii) në Norvegji, Ministrin e Financave dhe të Doganave ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij;

h) termi “nënshtetas” nënkupton:

(i) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;

(ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzon statusin si e tillë në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

i) termat “një Shtet Kontraktues” dhe “Shteti tjetër Kontraktues” nënkuptojnë Shqipërinë ose Norvegjinë siç e kërkon përmbajtja;

2. Përsa i përket zbatimit të kësaj Konvente nga një Shtet Kontraktues, çdo term i pa përcaktuar aty, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të atij Shteti lidhur me tatimet ndaj të cilave zbatohet Konventa; çdo kuptim i dhënë në ligjet tatimore në fuqi të atij Shteti do të ketë përparësi ndaj kuptimeve të dhëna termit në ligje të tjera të atij Shteti.

#### Neni 4 **Rezidenti**

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij Shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit, vendit të regjistrimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe përfshin gjithashtu atë Shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritet lokal atje. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë Shtet lidhur me të ardhurat nga burime vetëm në atë Shtet apo nga kapitali i vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese atëhere statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) ai do të konsiderohet rezident i Shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; nëqoftëse ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy Shtetet, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);

b) në qoftë se shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike nuk mund të përcaktohet, ose nëqoftëse ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin Shtet, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues në të cilin ai qëndron rregullisht;

c) nëqoftëse ai qëndron rregullisht në të dy Shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit nënshtetas i të cilit ai është;

d) nëqoftëse ai është nënshtetas i të dy Shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person juridik është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëhere ai do të konsiderohet rezident i Shtetit në të cilin ndodhet qendra efektive e drejtimit të tij.

#### Neni 5 **seli (përfaqësi) e përhershme**

1. Për qëllime të kësaj Konvente termi “seli (përfaqësi) e përhershme” nënkupton një

vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht aktiviteti i sipërmarrjes.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend drejtimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte; dhe

f) një minierë, një pus nafte ose gazi, ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” gjithashtu përfshin:

a) një shesh ndërtimi, një konstruksion, një projekt instalimi apo montimi ose aktivitete mbikqyrje që lidhen me to, por vetëm kur këto sheshe, projekte apo aktivitete vazhdojnë për një periudhë prej më shumë se gjashtë muaj;

b) ushtrimin e një aktiviteti biznesi nga ana e një sipërmarrje nëpërmjet të punësuarve apo çdo personeli tjetër, që furnizojnë një shërbim rrënjësisht të ngjashëm për një periudhë prej më tepër se gjashtë muajsh.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij Neni termi

“seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e pajisjeve apo objekteve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi;

c) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni, për sipërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim ushtrimi, për sipërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët a) deri e), me kusht që i tërë aktiviteti i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit aplikohet paragrafi 6- vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një sipërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues, kjo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin e përmendur në fillim lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, nëse ky person:

a) ka dhe zakonisht ushtron në Shtetin e përmendur në fillim një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4 të cilat, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk e bëjnë këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme në bazë të dispozitave të atij paragrafi; ose

b) nuk ka një autoritet të tillë, por zakonisht mban në Shtetin e përmendur në fillim një gjendje mallrash nga e cila aizakonisht shpërndan mallra në emër të sipërmarrjes.

6. Një sipërmarrje nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznes në atë Shtet nëpërmjet një ndërmjetesi, agjenti komisioner të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë në kuadrin e zakonshëm të aktivitetit të tyre.

7. Fakti që një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, ose që ushtron biznes në atë Shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera), nuk përbën në vetvete aresye të mjaftueshme për të konsideruar njërin shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

## Neni 6

### **Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme**

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufuktin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin, ose të drejtën për të shfrytëzuar, vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet dhe avionët nuk do të konsiderohen pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira, ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

## Neni 7

### **Fitimet nga biznesi i sipërmarrjeve**

1. Fitimet e një sipërmarrje të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet përveç kur sipërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Nëqoftëse sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes mund të tatohen në Shtetin tjetër por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet:

a) asaj selie të përhershme;

b) shitjeve në atë Shtet tjetër të mallrave në mënyrë të njëjtë ose të ngjashme me ato të shitura nëpërmjet asaj selie të përhershme; ose

c) aktiviteteve të tjera të biznesore të ushtruara në atë Shtet tjetër në mënyrë të njëjtë ose të ngjashme me ato të ushtruara nga ajo seli e përhershme.

Dispozitat e nën-paragrafëve b) dhe c) nuk do të zbatohen nëse sipërmarrja tregon se shitje ose aktivitete të tilla të ngjashme që i referohen atyre nën-paragrafëve nuk janë të lidhura me atë seli të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëhere në secilin Shtet Kontraktues selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte sikur ajo të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme nën kondita të njëjta ose të ngjashme, tërësisht e pavarur nga sipërmarrja seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, do të lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive, si në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme ashtu edhe gjetkë.

4. Kur në një Shtet Kontraktues përcaktimi i fitimeve që do ti atribuohen një selie të përhershme zakonisht bëhet në bazë të ndarjes të fitimeve totale të sipërmarrjes midis pjesëve të veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues për përcaktimin e fitimeve që do të tatohen në bazë të një metode të tillë; megjithatë, metoda e ndarjes së fitimeve duhet të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky Nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se ajo seli e përhershme blen mallra për sipërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mëparshëm, fitimet që i atribuohen një selie të përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit përderisa, nuk ka arsye të drejta dhe të mjaftueshme për të vepruar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në Nene të tjera të kësaj Konvente, atëhere dispozitat e atyre Neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij Neni.

#### Neni 8

### **Transporti ndërkombëtar**

1. Fitimet e një sipërmarrje të një Shteti Kontraktues nga veprimtaria e anijeve ose avjoneve në trafikun ndërkombëtar do të tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues.

2. Fitimet e një sipërmarrje të një Shteti Kontraktues nga përdorimi, mbajtja apo dhënja me qera e kontenierëve (përfshirë pajisjet e transportimit të kontenierëve) që përdoren për transportimin e mallrave do të tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues, përveç kur këto kontenierë apo pajisje të transportimit të tyre përdoren për transporte vetëm brenda përbrenda Shtetit tjetër Kontraktues.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një marrëveshje, një biznes të përbashkët apo në një agjensi ndërkombëtare transporti.

4. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 do të zbatohen ndaj fitimeve të realizuara nga konsorciumi i përbashkët Norvegjez, Danez dhe Suedezi i transportit ajror, Sistemi Ajror Skandinav (SAS), por vetëm për fitimet e realizuara nga "Det Norske Luftfartsselskap A/S (DNL)", partneri Norvegjez i Sistemit Ajror Skandinav (SAS), në bazë të pjesës (kapitalit) së tij në atë konsorcium.

#### Neni 9

### **Sipërmarrje të lidhura**

1. Kur:

a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë diktuar midis dy sipërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëhere çdo fitim që do të realizohej nga njëra sipërmarrje, por që për shkak të lidhjeve të veçanta të përmendura në fillim nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrje dhe të tatohet normalisht.

#### Neni 10

### **Dividentët**

1. Dividentët e paguar nga një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto dividentë mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues rezidente e të cilit është kompania pagueuse e dividentëve dhe në përputhje me ligjet e atij Shteti, por nëse marrësi është pronari përfitues i dividentëve tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë:

a) 5 përqind të shumës bruto të dividentëve nëse pronari përfitues është një kompani që zotëron direkt të paktën 25 përqind të kapitalit të kompanisë pagueuse të dividentëve;

b) 15 përqind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk do të ketë efekt mbi tatimin e kompanisë lidhur me fitimet nga të cilat janë paguar dividendët.

3. Në funksion të këtij Neni , termi “dividentë” nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji, ose të drejta të tjera, që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrja në fitime, si edhe të ardhurat nga të drejta të tjera korporative që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit rezidente e të cilit është kompania që bën shpërndarjen e dividendeve.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendeve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në një rast të tillë do të zbatohen, dispozitat e Nenit 7 ose Nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Kur një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky Shtet tjetër mund të mos zbatojë tatim mbi dividendet e paguar nga kompania, përveç kur këto dividendë i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër ose kur zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose bazë fikse të vendosur në këtë Shtet tjetër; subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të kompanisë, edhe sikur dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë Shtet tjetër.

#### Neni 11

#### **Interesat**

1. Interesat që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por, kur marrësi është pronari përfitues i interesave, dhe tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 përqind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese me mirëkuptim reciprok mund të vendosin mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesat do të përjashtohen nga tatimi në Shtetin Kontraktues ku krijohen, kur:

a) pronari përfitues i interesave është Banka Qendrore, Qeveria apo një nënndarje politike apo një autoritet lokal i Shtetit tjetër Kontraktues, dhe

b) në rastin e Norvegjisë, interesat përfitohen nga, ose huaja për të cilën krijohen interesat është dhënë, siguruar ose garantuar nga Instituti Norvegjez i Garantimit të Kredive të Eksportit ose “A/S Exportfinans”, ose çdo institucion tjetër i ngjashëm i financuar apo krijuar nga, ose në bashkëpunim me, Qeverinë e Norvegjisë, po të bihet dakord rast pas rasti midis autoriteteve kompetente të Shteteve Kontraktuese.

4. Termi “interesa” në kuptimin e përdorur në këtë Nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim, dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë dhe obligacionet qeveritare, përfshirë fitimet dhe shpërblimet nga këto letra me vlerë dhe obligacione. Gjodat e ngarkuara për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen si interesa për qëllime të këtij Neni .

5. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëqoftëse pronari përfitues i

interesave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin krijohen (lindin) interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në këtë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe kërkesa e huasë lidhur me të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me: a) këtë seli të përhershme ose bazë fikse, ose me b) aktivitetet e biznesit që i referohen nënparagrafit (c) të paragrafit 1 të Nenit 7. Në këto raste do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 ose 14, si të paraqitet rasti.

6. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është vetë ai Shtet, një nënndarje politike, një autoritet lokal ose një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi, dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëhere këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në Shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të marrëdhënieve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në huanë për të cilën paguhet, e kalon shumë mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij Neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

## **Neni 12** **Honoraret**

1. Honoraret (të ardhurat nga e drejta e autorit) që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto honorare mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por nëse marrësi është pronari përfitues i honorareve, dhe tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë 10 përqind të shumës bruto të honorarit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi.

3. Në funksion të këtij Neni , termi “honorare” nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin, ose të drejtën e përdorimit, të çdo të drejte të autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe filmat apo kasetat për transmetime radio televizive, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, apo për informacione lidhur me eksperiencën industriale, tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhet honoraret është efektivisht e lidhur me: a) këtë seli të përhershme ose bazë fikse, ose b) aktivitetet e biznesit që i referohen nënparagrafit (c) të paragrafit 1 të Nenit 7. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 ose Nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Honoraret do të konsiderohet se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është vetë ai Shtet, një nënndarje politike, një autoritet lokal ose një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e

pagimit të honorareve, dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëhere këto honorare konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke patur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëhere dispozitat e këtij Neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë, shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin normal do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të secilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

#### Neni 13

### **Fitimet nga tjetërsimi i kapitalit**

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme, që i referohen Nenit 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë e biznesit të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuritë e luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i kësaj baze fikse, mund të taten në këtë Shtet tjetër.

3. Fitimet e një sipërmarrje të një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve apo avionëve do të taten vetëm në atë Shtet Kontraktues.

4. Fitimet e realizuara nga një individ i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve apo i të drejtave të tjera në një kompani e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, si edhe fitimet nga tjetërsimi i opsioneve apo i instrumentave të tjera financiare të lidhura me aksione apo të drejta të tilla, mund të taten në atë Shtet tjetër, por vetëm nëse tjetërsuesi ka qenë rezident i atij Shteti tjetër në çdo kohë gjatë pesë viteve të fundit që pasojnë menjëherë pas momentit të tjetërsimit të aksioneve, të drejtave, opsioneve apo instrumentave financiare.

5. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve të një kompanie pasuria e së cilës konsiston direkt ose indirekt kryesisht në pasuri të patundshme të vendosura në një Shtet Kontraktues mund të taten në atë Shtet.

6. Fitimet e realizuara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i kontenierëve (përfshirë mjetet dhe pajisjet për transportimin e tyre) që përdoren për transportimin e mallrave do të taten vetëm në atë Shtet Kontraktues, përveç kur këto kontenierë dhe mjetet e pajisjet për transportimin e tyre janë përdorur vetëm për transporte brenda përbrenda Shtetit tjetër Kontraktues.

7. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët e mëparshëm do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

#### Neni 14

### **Shërbimet personale të pavarura**

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me shërbimet profesionale ose aktivitete të tjera të një karakteri të pavarur do të taten vetëm në atë Shtet. Megjithatë, këto të ardhura mund të taten gjithashtu në Shtetin tjetër Kontraktues, nëqoftëse:

a) nëse individi është prezent në Shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që në total i

kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës kalendarik; ose

b) individi ka një bazë fikse në Shtetin tjetër Kontraktues që rregullisht i shërben atij për kryerjen e aktiviteteve të tij;

por vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet shërbimeve të kryera në atë Shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo mësimdhënieje si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokateve, inxhinjerëve, arkitektëve dhe llogaritarëve.

#### Neni 15

##### **Shërbimet personale të varura**

1. Pa cenuar dispozitat e Neneve 16, 18, dhe 19, pagat, rrogat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të tatohen vetëm në atë Shtet përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë këto të ardhura mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Përfshirë dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të tatohen vetëm në Shtetin e përmendur në fillim, nëse plotsohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) përfituesi është prezent në Shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që në total nuk i kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës, dhe

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të, një punëdhënësi që nuk është rezident i Shtetit rezident i të cilit është përfituesi, dhe aktiviteti i të cilit nuk konsiston në rekrutimin e krahut të punës; dhe

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në Shtetin tjetër.

3. Përfshirë dispozitat e mëparshme të këtij Neni, shpërblimet e realizuara nga punësimi i ushtruar në bordin e një anije apo avjoni që operohet në trafikun ndërkombëtar nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues mund të tatohen në atë Shtet.

4. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues realizon të ardhura nga punësimi në bordin e një avjoni që operohet në trafikun ndërkombëtar nga konsorciumi i transportit ajror “Scandinavian Airlines System (SAS)”, këto të ardhura do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është përfituesi.

#### Neni 16

##### **Shpërblimet e drejtorëve**

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

#### Neni 17

##### **Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e Neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist teatri, kinematografie, radio-televizioni, muzikant, apo një sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë realizohen jo direkt nga sportisti apo artisti por nga një person tjetër, këto të

ardhura, pavarësisht nga dispozitat e Neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga aktivitetet e ushtruara në një Shtet Kontraktues nga artistët ose sportistët, nëqoftëse vizita në atë Shtet është e mbështetur kryesisht nga fonde publike të Shtetit tjetër Kontraktues apo një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje. Në një rast të tillë të ardhurat do të tatohen vetëm në Shtetin rezident i të cilit është artisti ose sportisti.

#### Neni 18

### **Pensionet dhe pagesa e shpërblime të tjera të ngjashme nën sistemin e sigurimeve shoqërore**

1. Pensionet (përfshirë pensionet Qeveritare dhe pagesat nga sistemi i sigurimeve shoqërore) dhe pagesat vjetore të kësaj natyre që i paguhen një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet.

2. Termi “pagesa vjetore të kësaj natyre (annuity)” nënkupton shumat në para apo në vlera të tjera që i paguhen individit periodikisht, në periudha të caktuara kohe gjatë jetës së tij ose gjatë një periudhe kohe të caktuar apo të pa fiksuar, si shpërblim kundrejt kuotave të parapaguara.

3. Pagesat ndaj një bashkëshorti të divorcuar (sipas një vendimi gjykate) dhe pagesa të tjera të ngjashme për jetesë që i paguhen një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet. Megjithatë, çdo pagesë e tillë e kryer nga një rezident i një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, me kusht që të mos njihet si një lehtësi (shpenzim) për paguesin, do të tatohet vetëm në Shtetin e përmendur në fillim.

#### Neni 19

### **Shërbimet qeveritare**

1. a) Pagat, rrogat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues, nga një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti apo autoriteti do të tatohen vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet janë kryer në atë Shtet dhe individ është rezident i atij Shteti, i cili:

(i) është nënshkretar i atij Shteti; ose

(ii) nuk është bërë rezident i atij Shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. Dispozitat e Neneve 15, 16 dhe 17 do të zbatohen ndaj pagave, shpërblimeve të tjera të ngjashme dhe pensioneve lidhur me shërbimet e kryera në lidhje me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, nënndarje politike apo autoritet lokal atje.

#### Neni 20

### **Studentët dhe specialistët**

Një student apo specialist i cili është ose ishte menjëherë para vajtjes në një Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që ndodhet në Shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim arsimimi apo specializimi, për pagesat që përfiton për qëllim të mbajtjes së tij, arsimimit apo specializimit, nuk do të tatohet në atë Shtet, me kusht që të tilla pagesa të lindin nga burime jashtë atij Shteti.

#### Neni 21

### **Aktivitetet në det**

1. Dispozitat e këtij Neni do të zbatohen pavarësisht nga dispozita e tjera të kësaj

Konvente.

2. Një person rezident i një Shteti Kontraktues që ushtron aktivitete në det në Shtetin tjetër Kontraktues për zbulimin dhe shfrytëzimin e tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tjera natyrore të ndodhura në atë Shtet tjetër, pa cenuar dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij Neni, do të konsiderohet se ato aktivitete ushtrohen në atë Shtet tjetër nëpërmjet një selie të përhershme apo baze fikse të vendosur aty.

3. Dispozitat e paragrafit 2 nuk do të zbatohen kur aktivitetet ushtrohen për një periudhë që nuk i kalon në total 30 ditë brenda çdo periudhe 12 mujore. Megjithatë, për qëllime të këtij paragrafi:

a) aktivitetet e ushtruara nga një sipërmarrje e lidhur me një sipërmarrje tjetër do të konsiderohen se ushtrohen nga sipërmarrja me të cilën është e lidhur nëse aktivitetet në fjalë janë në esencë të njëjta me ato të ushtruara nga sipërmarrja e përmendur në fund;

b) dy sipërmarrje do të konsiderohen të lidhura nëse njëra, direkt ose indirekt, kontrollohet nga tjetra, ose të dyja, direkt ose indirekt, kontrollohen nga i njëjti person apo persona të tretë.

4. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga transportimi i pajisjeve apo i personelit në një vend punimi në det ose mes vendeve të tilla, kur aktivitetet në lidhje me zbulimin dhe shfrytëzimin e tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore janë ushtruar në një Shtet Kontraktues, ose nga operimi i varkave apo anijeve që i shërbejnë aktiviteteve të tilla, do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku është rezidente sipërmarrja. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet nëse anija apo avjoni operohet nga një seli e përhershme në kuptimin e Nenit 5 të kësaj Konvente, apo të tilla aktivitete vazhdojnë për një periudhë prej më tepër se gjashtë muaj, në çdo periudhë 12-mujore.

5. a) pa cenuar dispozitat e nënparagrafit b) të këtij paragrafi, pagat, rrogat dhe shpërblime të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues për punësimin e lidhur me zbulimin dhe shfrytëzimin e tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, me kusht që puna të jetë kryer në det në atë Shtet tjetër, mund të tatohen në atë Shtet tjetër. Megjithatë, të tilla shpërblime do të tatohen vetëm në Shtetin e përmendur në fillim nëse punësimi ushtrohet në det për një punëdhënës i cili nuk është rezident i Shtetit tjetër dhe për një periudhë apo periudha që në total nuk i kalojnë 30 ditë në çdo periudhë 12 mujore.

b) Pagat, rrogat dhe shpërblime të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues për punën e ushtruar në bordin e një anije apo avjoni që merret me transportin e pajisjeve apo personelit në një vend punimi në det, apo mes vendeve të tilla, kur aktivitete të tilla lidhen me zbulimin dhe shfrytëzimin e tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore ushtrohen në Shtetin tjetër Kontraktues, ose lidhur me punën e ushtruar në bordin e një varke apo anije që operon në shërbim të aktiviteteve të tilla, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues rezidente e të cilit është sipërmarrja që ushtron këto aktivitete. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet nëse anija ose avjoni operohet nga një seli e përhershme në kuptimin e Nenit 5 të kësaj Konvente, ose aktivitetet vazhdojnë për një periudhë prej më tepër se 6 muaj në çdo periudhë 12 mujore.

6. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i:

a) të drejtave të zbulimit apo shfrytëzimit; ose

b) pasurisë së vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues dhe e përdorur për zbulimet në tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore të ndodhura në atë Shtet tjetër;ose

c) aksionet, vlera e të cilave tërësisht ose në masën më të madhe, direkt ose indirekt, rrjedh nga të drejta të tilla ose nga pasuri të tilla ose nga të drejta dhe pasuri të tilla të marra së bashku, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

Në këtë paragraf me “të drejta të zbulimit dhe shfrytëzimit” kuptohen të drejtat mbi asetet për t'u prodhuar nga zbulimi dhe shfrytëzimi i tabanit detar, nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore në Shtetin tjetër Kontraktues, përfshirë të drejtat e interesave në ose për përfitimin e

aseteve të tilla.

## Neni 22

### **Të ardhura të tjera**

1. Lloje të ardhurash të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me artikujt e mëparshëm të kësaj Konvente mund të tatohen në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, që nuk janë të ardhura nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të Nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë Shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 ose Nenit 14, si të paraqitet rasti.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, llojet e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, të cilat nuk mbulohen nga Nenet e mëparshme të kësaj Konvente, dhe që krijohen në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen gjithashtu në këtë Shtet tjetër.

## Neni 23

### **Kapitali**

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme që i referohen Nenit 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

3. Kapitali i zotëruar nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues dhe i përfaqësuar nga anije dhe avionë që veprojnë në trafikun ndërkombëtar, dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve dhe avionëve do të tatohet vetëm në këtë Shtet.

4. Kapitali i një sipërmarrje të një Shteti Kontraktues i përfaqësuar nga kontenierë (përfshirë mjetet dhe pajisjet për transportimin e këtyre kontenierëve) të përdorura për transportin e mallrave do të tatohen vetëm në atë Shtet Kontraktues, përveç kur ato kontenierë apo mjetet dhe pajisjet për transportimin e tyre janë përdorur për transportim vetëm brenda përbrenda Shtetit tjetër Kontraktues.

5. Të gjithë elementët e tjerë të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet.

## Neni 24

### **Eliminimi i tatimit të dyfishtë**

Tatimi i dyfishtë do të eliminohet si vijon:

1) Në Shqipëri:

a) Kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente mund të tatohen në Norvegji, Shqipëria do të lejojë:

i) një reduktim nga tatimi Shqiptar mbi të ardhurat e këtij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Norvegji; dhe

ii) një reduktim nga tatimi Shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Norvegji.

Megjithatë, në asnjë rast, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit Shqiptar të llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në Norvegji.

b) Kur në përputhje me dispozitat e Konventës të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohet nga tatimi në Shqipëri, në llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, Shqipëria merr në konsideratë të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Në Norvegji, bazuar në dispozitat e legjislacionit të saj lidhur me lejimin e kreditimit të tatimit Norvegjez për tatimin e paguar jashtë territorit të Norvegjisë (të cilat nuk bien në kundërshtim me parimin e përgjithshëm më poshtë):

a) Kur një rezident i Norvegjisë realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohen në Shqipëri, Norvegjia do të lejojë:

i) një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Shqipëri;

ii) një reduktim nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Shqipëri mbi elementë të kapitalit.

Megjithatë, në asnjë rast, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit Shqiptar të llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose elementëve të njëjtë të kapitalit që mund të tatohen në Shqipëri.

b) Kur në përputhje me dispozitat e Konventës të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Norvegjisë përjashtohen nga tatimi në Norvegji, në llogaritjen e të ardhurave ose të kapitalit të mbetur të këtij rezidenti, Norvegjia merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

3. Për qëllimet e paragrafit 2 të këtij Neni , tatimi mbi të ardhurat i paguar në Shqipëri nga një rezident i Norvegjisë lidhur me fitimet nga biznesi (Neni 7) do të konsiderohet të përfshijë çdo shumë që do të ishte paguar si tatim Shqiptar, por për shkak të përjashtimit apo reduktimit të tatimit sipas Ligjit Nr.7677, datë 3 Mars 1993 “Mbi Tatim Fitimin”, siç ka qenë në fuqi deri tani dhe nuk është modifikuar deri në datën e nënshkrimit të kësaj Konvente, ose është modifikuar vetëm në aspekte anësore pa efekte në karakterin e tij të përgjithshëm, ose, çdo dispozitë tjetër që mund të hyjë në fuqi për dhënien e një përjashtimi apo reduktimi të tatimit për të cilin bihet dakord nga autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese se këto përjashtime apo reduktime janë të një karakteri thelbësishëm, nëse ato nuk modifikohen më vonë, ose janë modifikuar vetëm në aspekte anësore duke mos e ndryshuar karakterin e tij të përgjithshëm. Dispozitat e këtij paragrafi do të zbatohen vetëm kur fitimet nga biznesi realizohen nga një aktivitet biznesi aktiv tregtar apo prodhues, të shitjes së mallrave apo kryerjes së shërbimeve brenda Shqipërisë, dhe nuk rrjedh nga shërbimet financiare, përveç kur autoritetet kompetente bien dakord se tërësia e aktiviteve nga krijohen të ardhurat i shërben zhvillimit ekonomik brenda Shqipërisë në përputhje me dispozitat ligjore të referuara në këtë paragraf. Dispozitat e këtij paragrafi do të zbatohen vetëm për pesë vitet e para gjatë të cilave kjo Konventë është efektive. Kjo periudhë mund të shtyhet me mirëkuptim reciprok midis autoriteteve kompetente.

## Neni 25

### **Mosdiskriminimi**

1. Nënshetësit e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë, në Shtetin tjetër Kontraktues, subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se sa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen nënshetësit e këtij Shteti tjetër në rrethana të njëjta. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e Nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo asnjërit prej Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në

Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë Shtet tjetër se sa tatimi i vjelur ndaj sipërmarrjeve të këtij Shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues lehtësime personale apo reduktime tatimore që i garanton rezidentëve të Shtetit të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familjare që ata kanë.

3. Përfshijë rastet kur zbatohen dispozitat e Nenit 9, paragrafit 6 të Nenit 11, ose paragrafit 6 të Nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kondita njëlloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të Shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kondita njëlloj sikur sipërmarrja të kishte kontraktuar me një rezident të Shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në Shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se sa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit të përmendur në fillim.

## Neni 26

### **Procedura e mirëkuptimit reciprok**

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit apo e të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre Shteteve, ai mund t'ja paraqesë rastin e tij autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues rezident i të cilit ai është, ose nëse çështja ka të bëjë me paragrafin 1 të Nenit 25, ai mund t'ja paraqesë atë Shtetit Kontraktues nënshtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, do të përpiqet t'a zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga limitet kohorë të përcaktuar nga ligji i brendshëm i secilit prej Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Konventës. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk sigurohet nga Konventa.

4. Autoritet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri tjetrin direkt për arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

## Neni 27

### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktues do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet e vëna nga Shtetet Kontraktuese përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit do të zbatohet për tatime të çdo lloji dhe

nuk kufizohet nga Neni 1. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij Shteti dhe do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve të vendosura në emër të atij Shteti. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ato mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktues detyrimin:

a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikën administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve dhe praktikës normale administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japë informacione që mund të nxirrin një sekret tregtar, industrial ose profesional apo informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

#### Neni 28

#### **Funksionarët diplomatikë dhe konsullorë**

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

#### Neni 29

#### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë do të ratifikohet dhe Shtetet Kontraktuese do të njoftojnë njëri tjetrin se kërkesat e tyre konstitucionale për hyrjen në fuqi të kësaj Konvente janë plotësuar.

2. Konventa do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit më të vonshëm që i referohet paragrafit 1 dhe dispozitat e saj do të kenë efekt lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas 1 Janarit të vitit kalendarik që pason atë të hyrjes në fuqi të Konventës.

Për qëllime të Nenit 27 (Shkëmbimi i Informacionit), dispozitat do të kenë efekt më ose pas datës në të cilën Konventa hyn në fuqi.

#### Neni 30

#### **Përfundimi**

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi deri në denoncimin nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Konventën, duke dhënë njoftimin me shkrim të përfundimit nëpërmjet kanalave diplomatike, të paktën 6 muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik që fillon pas përfundimit të një periudhe prej pesë vitesh nga data e hyrjes së saj në fuqi. Në rast të tillë, Konventa do të pushojë së pasuri efekt lidhur me të ardhurat e realizuara ose kapitalin e zotëruar më ose pas ditës së parë të Janarit të vitit kalendarik që pason atë të dhënies së njoftimit të përfundimit.

Në praninë dhe të autorizuar në mënyrën e duhur nga Qeveritë respektive, nënshkruesit kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në dy kopje në 14 tetor më ..... , në gjuhën Angleze.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SE  
SHQIPËRISË

PER QEVERINË  
E MBRETËRISË SË NORVEGJISË